

MIRE SE ERDHET NE SHKOLLE! INFORMACIONE SHKOLLORE PER BASHKESHTETAS TE HUAJ¹

ARSIMI I PERGJITHSHEM I DETYRUESHEM

Për të gjithë fëmijët të ndodhur me qëndrim të vazhdueshëm në Austri (së paku për një periudhë të vlerësuar një semestër shkollor, afërsisht 6 muaj) ekziston detyrimi i arsimimit të përgjithshëm. Fëmijët me qëndrim më afatshkurtër në Austri nuk janë të detyruar të frekuentojnë shkollën, por megjithatë gëzojnë të drejtën të shkojnë në të (§§ 1 dhe 17 SchPflG).

Me fjalën fëmijë kuptohen këtu të miturit që kanë për detyrë apo të drejtë frekuentimin e një shkolle të përgjithshme të detyrueshme. Shkolla të përgjithshme të detyrueshme janë: Shkolla fillore (cikli i ulët i shkollës nëntëvjeçare, kl. I - IV), cikli i lartë i shkollës nëntëvjeçare (kl. V - IX), shkollat speciale si dhe shkollat politeknike (§ 3 Anm. 4 SchOrgG).

FILLIMI DHE ZGJATJA E ARSIMIT TE PERGJITHSHEM TE DETYRUESHEM

Detyrimi i arsimimit të përgjithshëm fillon në shtator të çdo viti pas mbushjes së moshës 6 vjeç dhe zgjat 9 vite shkollore (§§ 2 dhe 3 SchPflG).

SHPENZIMET E SHKOLLIMIT

Frekuentimi i shkollave shtetërore (publike) është parimisht pa pagesë. Përkundër kësaj frekuentimi i shkollave private (jopublike) është me detyrim pagese (§ 5 Anm. 1 SchOrgG).

FILLIMI I VITIT SHKOLLOR

Viti shkollor në Steiermark fillon të hënën e dytë të muajit shtator (§ 2 Abs. 1 SchZG).

NDERRIMI I SHKOLLES

Për çdo shkollë të përgjithshme të detyrueshme shtetërore ekziston e drejta e ndërrimit të objektit. E drejta e ndërrimit të objektit shkollor përfshin territorin e përcaktuar me ligj të shkollës së detyrueshme publike (§ 13 Abs. 1 dhe Anm. 1 PflSchErh-GG). Në llojet e tjera të shkollave nuk njihet e drejta e ndërrimit të objektit shkollor (§ 4 Anm. 6 SchOrgG).

PRANIMI SI NXENES/E I/E RREGULLT

Pranohet si nxënës/e i/e rregullt kushdo: a) që përmbush kushtet ligjore mbi pranimin në llojin dhe në nivelin e shkollës përkatëse b) që zotëron gjuhën e mësimin në atë masë, që është në gjendje ta ndjekë atë dhe c) që është i aftë nga ana shëndetsore dhe fizike për llojin e shkollës përkatëse (§ 3 Abs. 1 SchUG).

PRANIMI SI NXENES/E I/E JASHEM/E

Nëse njohuritë në gjuhën gjermane të një nxënës-i/-eje janë të pamjaftueshme për ndjekjen e mësimin, ekziston mundësia e pranimit si nxënës i/e jashtëm/e. Puna mësimore e nxënësve të jashtëm nuk duhet të vlerësohet me notë. Pranimi si nxënës i jashtëm për fëmijët që kanë detyrimin shkollor aprovohet parimisht për së shumti 12 muaj. Për nxënësit me gjuhë amtare jo gjermane afati mund të zgjatet maksimumi edhe me 12 muaj të tjerë. Për nxënësit, që pranohen në shkollë gjatë gjysmës së dytë të vitit shkollor, ky semestër nuk përlogaritet në afatin dyvjeçar (§ 4 Abs. 2 dhe 3 SchUG).

PROVIMI I KLASIFIKIMIT

Nxënësit, që kanë frekuentuar shkollat jashtë shtetit dhe që për rrjedhojë dëshirojnë të pranohen në klasën e dytë apo në një më të lartë si nxënës të rregullt, në parim duhet të kryejnë provimin e klasifikimit. Qëllimi i tij është të konstatojë nëse formimi i nxënësit është i mjaftueshëm për nivelin shkollor të kërkuar. Provimi mund të mos kryhet, në rastin kur rezultatet e nxënës-it/-es dëshmojnë që njohuritë e nivelit (niveleve) të mëparshëm shkollor zotërohen plotësisht (§ 3 Abs. 6 SchUG).

GJUHA MESIMORE

Gjuhë mësimore është gjuha gjermane aty ku nuk bëhet fjalë për shkollat, të cilat janë caktuar për minoritetet dhe që parashikohen ndryshe me ligj apo përmes marrëveshjeve ndërshtetërore. Në shkollat private ka përjashtime të tjera (§ 16 Abs. 1 dhe 2 SchUG).

¹ Përgatiti/Adresa: LANDESSCHULRAT FÜR STEIERMARK, BERATUNGSSTELLE FÜR MIGRANTINNEN UND MIGRANTEN, 8011 Graz, Postfach 663, Körblergasse 23/IV/514, Tel.: 0316/345/198, Fax: 0316/345/455, E-Mail: gottfried.kerschbaumer@sr-stmk.gv.at.

KEMBIMI I GJUHEVE

Me kërkesë të një nxënësi, gjuha amtare e të cilit **nuk** është e njëjtë me gjuhën mësimore të shkollës përkatëse, është në kompetencë të drejtorisë së shkollës të vendosë, që, përsa i përket vlerësimit, **gjuha mësimore** e tij të hyjë në vend të **gjuhës së huaj të gjallë**, nëse **një gjuhë e huaj e gjallë** është e **parashikuar në planin mësimor si lëndë e detyrueshme** në nivelin përkatës të shkollimit. Nxënësi në rast nevojë mund të dëshmojë rezultatet në gjuhën amtare, të cilat u përgjigjen atyre të nxënësve me gjuhë amtare gjermanisht në lëndën e detyrueshme të gjermanishtes edhe në formën e provimeve të quajtura (**Externistenprüfungen**), në qoftë se është e mundur kryerja e provimeve në gjuhën përkatëse. Pra, **kusht** është: a) Nxënësi **duhet** të frekuentojë një lloj shkolle (formë, drejtim specialiteti) në një klasë, në të cilën **një gjuhë e huaj e gjallë** (jo kjo) parashikohet si **lëndë e detyrueshme** në planin mësimor; b) **Këmbimi në vlerësim** mund të kryhet **vetëm** me një **gjuhë të huaj të gjallë**, që parashikohet sipas planit mësimor si **lëndë e detyrueshme** ose **me zgjedhje**; c) **Provimi** (në rast nevojë Externistenprüfung) **duhet të jetë i mundshëm** (§ 18 Abs. 12 SchUG).

Një **këmbim** i tillë **gjuhësh** është për pasojë i mundshëm edhe **me të gjitha gjuhët në ciklin e lartë të shkollës 9 - vjeçare** (Hauptschule) dhe në **shkollat politeknike**, në të cilat zhvillohet **mësimi i gjuhës amtare** (ose është zhvilluar), për arsye se për to ekziston një **plan mësimor** përkatës.

MESIMI NE GJUHEN AMTARE

Në shkollat e Austrisë nxënësit, që nuk kanë gjermanishten si gjuhë amtare, mund të marrin mësim në gjuhën amtare në kushte të caktuara në masën nga **2** deri në **6** orë javore: Në **nivelin parashkollor** (Vorschulstufe), në **shkollën fillore** (Volksschule) dhe në **shkollën speciale** (kl. I – V) mësimi i gjuhës amtare **mund** të ofrohet si **lëndë** (ushtrim) **pa notë**. Në **ciklin e lartë të shkollës 9 - vjeçare** (Hauptschule), të (**Volksschuloberstufe**), të **shkollës speciale** (kl. VI – VIII) dhe të **shkollës politeknike** mësimi i gjuhës amtare **mund** të ofrohet si **lëndë** (ushtrim) **pa notë** ose si **lëndë me zgjedhje (me notë)**. Në **shkollat e mesme të përgjithshme** si dhe në **shkollat profesionale** mësimi i gjuhës amtare **mund** të ofrohet në kuadër të **autonomisë së shkollës si lëndë** (ushtrim) **pa notë** ose si **lëndë me zgjedhje (me notë)**.

ÇFARE DUHET BERE PER T'U PRANUAR NE NJE SHKOLLE AUSTRIAKE?

Pranimi në një shkollë parakupton regjistrimin në shkollën përkatëse (në drejtorinë e saj). Për lloje të veçanta shkollash vlejné rregullat e mëposhtme:

Shkollat fillore:	Nxënësit fillestarë duhet të paraqiten personalisht tek drejtues-i/-ja e shkollës. Dokumentet e marra me vete: Certifikatë lindje e fëmijës, fletëregjistrim (Meldezettel), dokument nënshpëtësie, vërtetim pagëzimi ose dëshmi të ndryshme besimi.
Cikli i lartë i shkollës 9-vjeçare:	Regjistrimi kryhet si rregull përmes drejtorisë së shkollës fillore, që frekuenton nxënës-i/-ja, ndryshe ndodh (p. sh. në Grac), ku ai kryhet prej personit përgjegjës për edukimin e fëmijës (prindit apo kujdestarit) që prej të hënës pas përfundimit të pushimeve semestrale.
Shkollat politeknike:	Regjistrimi kryhet si rregull përmes drejtorisë së ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare (Hauptschule), që frekuenton nxënës-i/-ja, ndryshe ndodh (p. sh. në Grac), ku ai kryhet prej personit përgjegjës për edukimin e fëmijës (prindit apo kujdestarit) që prej të hënës pas përfundimit të pushimeve semestrale.
Shkollat profesionale: Shkollat e mesme të përgjithshme:	Regjistrimi përmes autoriteteve mësimdhënëse. Afati i regjistrimit: Një javë pas përfundimit të pushimeve semestrale. Dokumentet e marra me vete: Për klasën I: Fletëregjistrim (Meldezettel), dokument nënshpëtësie, dëshmi shkollorë të klasës IV të shkollës fillore (Volksschule), pra dëftesë semestrale; Për ciklin e lartë të gjimnazit real (Oberstufenrealgymnasium): Certifikatë lindje, dëshmi shkollorë të klasës IV të ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare (Hauptschule), pra dëftesë semestrale.
Shkolla të mesme të formimit profesional:	Afati i regjistrimit: Një javë pas përfundimit të pushimeve semestrale. Dokumentet e marra me vete: Formulari i regjistrimit i shkollës, dëftesa e klasës IV.